



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së dytë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 12.06.2020, e cila filloi në orën 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli – Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Mehreme Llumnica, Jeton Tanhasi, Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani.**

**Munguan: Ramadan Salihu, dhe Armend Ademi.**

**E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatorë e Njësisë për të drejtat e njeriut.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese.**

Ajo tha se qëllimi i këtij takimi ka qenë të diskutojmë për situatën e krijuar si pasojë e Covid -19. Ka qenë e planifikuar që të ftohet në takim drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë për të na raportuar se a ka të prekur nga Covid- 19 ndonjë person me aftësi të kufizuara, por ishte e pamundur, për shkak të angazhimeve të mëdha rreth menaxhimit të situatës së krijuar.

**Mehreme Llumnica** tha se në qytet vitin e kaluar e kemi prezantuar në Kuvendin e Komunës një raport për punësimin e PAK, si dhe Planin e veprimit, ku është miratuar. Andaj unë propozoj që në pikën “Të ndryshme” të diskutohet lidhur me mundësinë që ndonjë anëtarë i Komitetit me marrë pjesë së paku në ndonjë seanca të Kuvendit, me shikuar se a është diskutuar për çështjen e aftësive të kufizuara, ose edhe me ngrit çështjen, me pyetur se çka është bërë me ato konkluzionet, raportimin për punësim dhe Planin e veprimit.

**Premtime Preniqi** theksoi se duhet biseduar me kryesuesin e Kuvendit, që me u përfshirë si pikë e rendit të ditës, me përgatitur dhe me caktuar se kush do ta prezantojë.

**Kryesuesja konstatoi se u miratua ky**

### **REND DITE :**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;**
- 2. Diskutim rreth gjendjes së krijuar nga Covid - 19 lidhur me PAK;**



3. Lirimi nga taksat dhe tatimi i personave të verbër, konform dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-092 për personat e verbër;
4. Lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga shërbimet komunale (mbeturinat, uji, ngrohja, tatimi në pronë), konform pikës 11 të Planit të veprimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës;
5. Liria e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara (pjerrinat, parmakët në shkallë, trotualet e ngarkuara me makina, ashensorët), konform pikës 12 të Planit të veprimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës;
6. Rekomandime;
7. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

#### **Pika e dytë**

Diskutim rreth gjendjes së krijuar nga Covid-19 lidhur me PAK.

Mehreme Llumnica dha sqarime lidhur me gjendjen e PAK gjatë kohës së pandemisë – Covid- 19, duke cekur se është pjesëtare në ekipet vëzhguese për siguri në Bashkësi nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ambasada amerikane, ku kam pasur kontakte të vazhdueshme me të gjitha ekipet në komunat që veprojnë, pastaj me të gjitha degët e “Hendikos”, të gjitha komunat dhe organizatat që veprojnë, për llojet e tjera të aftësive të kufizuara, por nuk është raportuar për ndonjë rast të prekur të komunitetit PAK.

Edhe sa i përket personave me aftësi të kufizuara fizike, nuk kemi asnjë raste të prekur me Covid- 19.

Sa i përket Komunës së Prishtinës, ka qenë shumë më e interesuar për çështjen e PAK, ku ka siguruar edhe pako. Sa i përket Hendikosit, Komuna e Prishtinës iu kanë ndarë veçantë ato pakot për raste sociale, por edhe shumicës së organizatave tjera iu ka shpërndarë pako.

Po ashtu, edhe nga niveli qendror ka qenë e mirëseardhur që personat të cilët kanë pasur të angazhuar asistentë personal, pa pasur kontratë përmes Ministrisë dhe organeve institucionale në mënyrë individuale, iu ka mundësua përmes Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Ministria e Punëve të Brendshme iu ka dhënë leje qarkullimi në kohën e kufizimeve të përgjithshme.



Një fatkeqësi ka qenë për shkak të mungesës së transportit, që u ndërpre trafiku urban dhe ndërurban, në mungesë të përkujdesjes familjare. Ka persona që nuk kanë përkujdesje familjare, për shkak të vdekjes së prindërve dhe për shkaqe të ndryshme kanë qenë të vetmuar dhe kanë pasur asistentin personal të angazhuar. Ata detyrimisht janë obliguar me shkuar në ambientin tjetër, asistenti i ka marrë në shtëpi të vet, sepse nuk kanë pasur përkujdesje totale dhe kanë qëndruar dy - tre muaj.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore, nuk kam pasur ndonjë patronazh, edhe pse e kam pasur në evidencë me shkuar me evidentua një person me aftësi të kufizuara, përveç UNICEF-it që ka dërguar në Hendikos pako higjienike edhe me mjete për inkontinim, se detyrimisht ju duhen përdorueseve, si ata paraplegjik, ku Hendikosi përmes UNICEF-it, kanë pasur konsideratë dhe iu kanë siguruar.

**Gyltene Retkoceri** tha se ne po e shohim në situatë normale si po trajtohen, e le më në situatë pandemie. Besoj që kjo periudhë për ta ka qenë shumë e vështirë, sepse kanë qenë në shtëpi gjatë gjithë kësaj periudhe dhe nuk kanë mundur t'i marrin shërbimet si duhet.

**Mehreme Llumnica** lidhur me këtë tha se atyre iu kanë munguar përkujdesja shëndetësore, sociale deri diku, mirëpo Komuna e Prishtinës ka pasur konsideratë kur e ka bërë listën për PAK, e ka bërë një renditje përmes organizatave që veprojnë për personat me aftësi të kufizuara, po ashtu edhe shoqata "Bereqeti" dhe partia turke që merret me këtë çështje.

#### **Pika e tretë**

**Lirimi nga taksat dhe tatimi i personave të verbër, konform dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-092, për personat e verbër.**

**Premtime Preniqi**, sa i përket lirimit nga taksat dhe tatimi i personave të verbër, konform dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-092, për personat e verbër, tha se duhet drejtuar Drejtorisë së Pronës me kërkesë, por duhet bashkëngjitur edhe Drejtorisë së financave.

**Mehreme Llumnica** propozoi që kur t'u dërgohet emaili drejtorive përkatëse, me iu bashkëngjitur edhe Plani i veprimit të PAK.

**Premtime Preniqi** theksoi se mundeni me ndarë nga Plani i veprimit pjesën që i takon atij dhe me ia dërguar.

**Premtime Preniqi** tha që t'u dërgohet edhe kryetarit dhe nënkryetarit.

#### **Pika e katërt**

**Lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga shërbimet komunale (mbeturinat, uji, ngrohja, tatimi në pronë), konform pikës 11 të Planit të veprimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës.**



**Premtime Preniqi** tha se sa i përket lirimit të PAK nga shërbimet komunale, këtu është një problem, sepse është numër shumë i vogël i pjesëtarëve të PAK që kanë prona në emër të tyre.

**Mehreme Llumnica** tha, për shembull te Ligji paralegjik KEK-u, tash Ministria e zhvillimit, ku me Ligj është lirimi nga pagesa e prindërve të anëtarëve të PAK, me një përqindje si të rastet sociale, por tash dilema po del se asnjë orë nuk është në emër të vet, por edhe personi që ka pronë tash është problem shitblerjet, nuk janë përkthyer orët.

**Fatime Demolli - Mustafa** pyeti se a nuk munden të ky ligj me u përshtirë familjarët e PAK.

**Ermira Shabani** tha se sa kam njohuri unë, këto ligjet që janë në fuqi për PAK nuk e kanë tregu në këtë mënyrë, tash me Ligjin e ri që është duke u draftuar, janë duke u bërë në këtë formë që familja e personit me PAK me u liruar.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha se pasi që qenka duke u bërë draftligji për këto çështje, po presim të finalizohet e mandej po ju drejtohem drejtorive me kërkesa për lirim.

**Premtime Preniqi** tha ju vazhdoni me këto pika dhe drejtoheni Drejtorisë së Pronës, Financave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Mehreme Llumnica** shprehu mendimin që gjatë takimit me iu dhënë sugjerime se pjesëtarët e PAK të cilët e kanë orën e rrymës në emër të tyre të lirohen tërësisht, e ata që nuk e kanë familja me dëshmuar me deklaratën familjare që kjo familje jeton me një PAK, që së paku të ketë zbritje ose në rast të borxhit, me ia mundësuar së paku me këste me kryer obligimin.

**Premtime Preniqi** tha se kjo varet krejtësisht nga ajo se si parashihet me ligj dhe ashtu duhet zbatuar.

**Mehreme Llumnica** tha ka qenë një pjesë e Ligjit ashtu nëse ka borxhe është person përdorues tek paralegjik me ja mundësua së paku me këste.

#### **Pika e pestë**

**Liria e lëvizjes për persona me aftësi të kufizuara (pjerrinat, parmakët në shkallë, trotualet e ngarkuara me makina, ashensorët), konform pikës 12 të Planit të veprimtimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës.**

**Fatime Demolli - Mustafa**, sa i përket kësaj pike, tha se lëvizja e lirë e PAK e kemi diskutuar thujse çdo takim.

**Gyltene Retkoceri** shprehu mendimin se përderisa nuk është bërë asgjë deri tash, atëherë domosdo duhet shtyer këtë çështje.

**Mehreme Llumnica** theksoi se ne duhet thirrur në Udhëzimin administrativ, është për qasjen në infrastrukturë komplet, e ka Komuna, është dalë edhe raporti prej "Hendikos", për qasje në objektet që janë të qasshme, trotualet, shtigjet për të verbrit etj.

**Premtime Preniqi** tha prej këtij planit "Prishtina për të gjithë", në këtë drejtim është përmirësuar diçka, është bërë ashensori, tualeti etj.

**Mehreme Llumnica** bëri të ditur se edhe në QMF-të ka shërbim me gjuhën e shenjave, edhe shtigjet e të verbërve i kanë bërë, kanë bërë përmirësime me ashensorë, me rënie, me rampa etj.

**Fatime Demolli - Mustafa** shprehu mendimin se institucionet shkollore nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim.



**Ermira Shabani** theksoi se tani po shihet se janë duke i rregulluar stacionet e pritjeve të autobusëve, por nuk e di se si kanë vendosur, po flitet për digjitalizim, atëherë kishte qenë mirë me shqyrtua këtë mundësinë, që me u përshtatur, në mënyrë që informacionet që jepen me u përshtatur edhe për PAK, të verbërve etj.

**Premtime Preniqi**, kurë të shihni që kryetari apo Komuna ka publikuar diçka, edhe nëse nuk i shkruani drejtpërdrejt kryetarit në komente, të paktën shkruani ose si e-mail, ose si mesazh ndonjë sugjerim.

**Fatime Demolli - Mustafa** theksoi se si ta kishim pasur një person që ndoshta na kishte ndihmuar më shumë që me iu bërë si presion për një gjë të tillë, në të kundërtën nuk jam duke parë shumë rezultate.

**Mehreme Llumnica** pyeti lidhur me mundësinë e mbajtjes së një takimi të rregullt me drejtorët, të cilëve po iu drejtohem me kërkesa, me pikat që i cekëm.

**Fatime Demolli - Mustafa** theksoi se këtë mund ta bëjmë në javën e parë të korrikut, me mbajtur një takim dhe me kërkuar prej nënkryetarit, z. Muhedin Nushi, me i ftuar drejtorët për të cilët vendosim ne.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që t'u dërgohen e-maillet drejtorive, pastaj t'i shikojmë mundësitë e mbajtjes së një takimi, sepse drejtorët kanë çështje më madhore, sepse janë të ngarkuar shumë.

**Ermira Shabani** sugjeroi që Komiteti të konsultohet me komitetet tjera brenda komunës, që me marrë parasysh rritjen e rolit të komiteteve. Po ashtu, me i dërguar e-mail Drejtorisë së Shërbimeve Publike për çështjen e stacioneve dhe me pyetur si ka me qenë, gjegjësisht a i plotëson nevojat e të gjithë qytetarëve të Prishtinës, pavarësisht a është me aftësi të kufizuara apo jo.

**Gyltene Retkoceri** tha se sido që të jenë, vetëm të jenë të përshtatshme për të gjithë.

**Ermira Shabani** tha se kishte qenë mirë para se të marrin ndonjë proces të tillë, të marrin një iniciativë drejtoritë që ta ftojnë Komitetin për konsultime.

**Fatime Demolli - Mustafa** sugjeroi mbajtjen e një takimi me dy nënkryetarët dhe nëse ka çështje të rregullimit të infrastrukturës, puna e sinjaleve etj., Komuna me ftuar një anëtarë të Komitetit për dhënien e sugjerimeve se çka munden me bërë në këtë drejtim. Në të kundërtën, ne e kemi shumë vështirë, ne nuk e kemi ditur paraprakisht që po rregullohen stacionet, ato veç i kanë kryer kontratat, janë kryer të gjitha procedurat, kotë japim ne sugjerime tani, ata i kanë specifikuar me detale.

**Premtime Preniqi** propozoi që të shkruajnë e-mail, sepse nëse e shohin të arsyeshëm e-mailin e juaj me atë shumën që e kanë, kanë mundësi tenderin me rritur dhe e rregullojnë pa u kryer krejt puna.

Në bazë të diskutimeve, Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nxori këto

## REKOMANDIME:



1. Dërgimin e e-mailit për Lirimin nga taksat dhe tatimi të personave të verbër, konform dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-092, për personat e verbër, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Financave dhe dy nënkryetarëve;
2. Dërgimin e e-mailit për Lirimin e personave me aftësi të kufizuara nga shërbimet komunale (mbeturinat, uji, ngrohja, tatimi në pronë), konform pikës 11 të Planit të veprimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Financave, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe me ia përcjellë edhe kryetarit dhe të dy nënkryetarëve;
3. Dërgimin e-mailit për Lirin e lëvizjes për persona me aftësi të kufizuara (pjerrinat, parmakët në shkallë, trotuaret e ngarkuara me makina, ashensorët), konform pikës 12 të Planit të veprimit 2018-2020 për persona me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Financave, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe kryetarit dhe të dy nënkryetarëve;
4. Dërgimin e-mailit Drejtorisë së Shërbimeve Publike për çështjen e digjitalizimit të pritjes së autobusëve, se a jeni në rrjedha në lidhje me PAK, sa shërbejnë këto për PAK, nëse ka mundësi me ndikuar derisa nuk është kryer procesi në tërësi;
5. Në takimin që do të mbahet në javën e parë të korrikut, me i ftuar në takim të njëjtit drejtorë që ju kemi bërë kërkesa.

*Mbledhja përfundoi në orën 15:00.*

Procesmbajtësja:  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

